



BULETIN MUJOR

JANAR 2026



PËRMBAJTJA

- Auditimi i sigurisë kibernetike në fokus të trajnimit me infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit
- Marrëveshje bashkëpunimi mes AKSK dhe Universitetit Western Balkans
- AKSK organizon takim koordinues me organet ligjzbatuese
- Trajnimi i AKSK shtrihet në shkolla përmes modelit trajnim-për-trajnerë
- AKSK zhvilloi një trajnim praktik në sigurinë kibernetike për studentët e Tirana College of Technology
- Studentë nga Universiteti i Leidenit zhvillojnë vizitë studimore në AKSK

Auditimi i sigurisë kibernetike në fokus të trajnimit me infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me DCAF, zhvilloi një trajnim me përfaqësues nga infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, me fokus implementimin e masave të sigurisë kibernetike dhe zbatimin e standardeve përkatëse.

Trajnimi synoi rritjen e kapaciteteve profesionale për realizimin e auditimeve të sigurisë kibernetike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, dhe është pjesë e një serie trajnimesh që do të vijojnë gjatë vitit në mbështetje të forcimit të sigurisë së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme.

Marrëveshje bashkëpunimi mes AKSK dhe Universitetit Western Balkans

Forcimi i bashkëpunimit me universitetet është një element kyç i vizionit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbulimin e talenteve të rinj dhe ndërtimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike. Në këtë kuadër, AKSK nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Western Balkans.

Marrëveshja u shoqërua me zhvillimin e një trajnimi praktik “Cyber Drill” për studentët e sigurisë kibernetike, i bazuar në skenarë realë dhe ushtrime konkrete reagimi ndaj incidenteve kibernetike, duke hapur rrugën për iniciativa të mëtejshme të përbashkëta dhe rritjen e aftësive profesionale të studentëve.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039

JANAR 2026

AKSK organizon takim koordinues me organet ligjzbatuese

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një takim me përfaqësues të organeve ligjzbatuese, me fokus forcimin e bashkëpunimit institucional në fushën e sigurisë kibernetike, në përputhje me vizionin e AKSK për ndërtimin e një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme në përballimin e kërcënimeve kibernetike.

Takimi u përqendrua në prezantimin e kapaciteteve institucionale, diskutimin e qasjeve për menaxhimin e incidenteve kibernetike dhe identifikimin e mundësive për bashkëpunim të mëtijshëm përmes ndarjes së ekspertizës dhe koordinimit teknik, me synimin rritjen e gatishmërisë dhe forcimin e sigurisë institucionale në nivel kombëtar.



Trajnimi i AKSK shtrihet në shkolla përmes modelit trajnim-për-trajnerë

Pas trajnimit të organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për senatorët e shkollave të mesme, ku u ofruan njohuri praktike mbi higjienën kibernetike dhe sigurinë online, një nga pjesëmarrësit e trajnuar në kuadër të programit trajnim-për-trajnerë zhvilloi një sesion informues në gjimnazin "Asim Vokshi".

Gjatë sesionit u prezantuan konceptet bazë të mbrojtjes në hapësirën digjitale, përfshirë përdorimin e fjalëkalimeve të sigurta, identifikimin e përmbajtjeve të dyshimta, sjelljen e sigurt në rrjetet sociale dhe praktikën e përditshme që rrisin nivelin e sigurisë online, në kuadër të bashkëpunimit mes AKSK dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.



AKSK zhvilloi një trajnim praktik në sigurinë kibernetike për studentët e Tirana College of Technology

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një Cyber Drill praktik për studentët e Tirana College of Technology, me fokus skenarë realë dhe ushtrime konkrete reagimi ndaj incidenteve kibernetike në hapësirën digjitale.

Aktiviteti synoi forcimin e njohurive dhe aftësive praktike të studentëve në fushën e sigurisë kibernetike, përmes një qasjeje të orientuar drejt praktikës dhe shkëmbimit të ekspertizës profesionale.



Studentë nga Universiteti i Leidenit zhvillojnë vizitë studimore në AKSK

45 studentë nga Universiteti i Leidenit në Holandë, nga programi i Administrimit Publik, zhvilluan një vizitë studimore pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Gjatë vizitës, studentët u njohën me përvojën konkrete të Shqipërisë në këtë fushë, me fokus reagimin institucional, koordinimin ndërmjet strukturave përkatëse dhe rolin e administratës publike në menaxhimin praktik të situatave kibernetike, duke zhvilluar diskutime dhe pyetje të lidhura me programin e tyre të studimit.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039